



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2021

**V E N D I M**

**Nr. 111, datë 17/06/2021**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 154, datë 21.12.2020, e znj. I.P., ku pretendohet diskriminim për shkak të gjinisë, vendbanimit dhe për çdo shkak tjetër, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Mbështetur në ankesën e sipërcituar rezulton se znj. I.P. ka konkuruar për pozicionin vakant për Drejtor të Shkollës 9-vjeçare “Aleksandër Paloci”, Shelqet, Vau i Dejës, pas shpalljes së procedurave të konkurimit nga ana e Drejtorisë Rajonale e Arsimit Parauniversitar Lezhë (DRAP) Lezhë.

Pas përfundimit të procedurave të konkurimit, znj. I.P. është njoftuar se është shpallur fituese, me e-mailin e datës 19.10.2020, së DRAP Lezhë. Në vijim, me e-mailin e datës 29.10.2020, DRAP Lezhë e ka anuluar njoftimin për shpalljen fituese të znj. I.P., me arsyetimin se ajo nuk është ende pjesë e sistemit arsimor, pasi është në pritje për t’u punësuar përmes Portalit “Mësues për Shqipërinë”. Në vend të ankueses është shpallur fitues z. F.N., i cili ishte gjithashtu kandidat për pozicionin e sipërcituar të punës.

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

Ankuesja informon se ka bërë ankesë në Platformën për Bashkëqeverisjen, si dhe në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Ankesa e saj është shqyrtuar nga një grup pune i caktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar. Nga shqyrtimi i ankesës së znj. I.P. rezulton se ky institucion ka miratuar Raportin e Vlerësimit nr. 3504/1, datë 10.12.2020. Në këtë Raport, grupi i punës ka dalë në përfundim se veprimet e drejtuesit të DRAP Lezhë për anulimin e shpalljes fituese së znj. I.P. janë të pabazuara në Udhëzimin nr. 2, datë 28.01.2020, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “*Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar*” dhe DRAP Lezhë i rekomandohet të marrë masa për zbatimin e këtij akti. Raporti i sipërpërmendur i është dërguar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe DRAP Lezhë.

Për sa më sipër, ankuesja pretendon diskriminim për shkak të gjinisë, pasi personi që është emëruar në pozicionin e Drejtorit të Shkollës 9-vjeçare “Aleksandër Paloci”, Shelqet, Vau i Dejës është z. F.N. Ankuesja pretendon gjithashtu që z. F. N. ka dorëzuar në dosjen e tij të konkurimit, dokumente të pavërteta, që sipas Znj. I.P. kanë të bëjnë me faktin se z. F.N. ka punuar si drejtor i Shkollës së Mesme të Bashkuar në Pistull. Ndërkohë që, znj. I.P. pretendon, se ai gjithnjë është paguar si mësues. Njëkohësisht, ankuesja ngre pretendimin se DRAP Lezhë ka anuluar shpalljen e saj, si fituese për pozicionin e punës, pasi z. F. N. është pjesë e Këshillit Bashkiak të Vaut të Dejës, pozicion, ky që e ka favorizuar më tepër se të.

Përveç sa më sipër, ankuesja pretendon se është diskriminuar edhe për shkak të vendbanimit, pasi ajo banon në Shkodër dhe konkurenti tjetër, z. F.N. është nga fshati Shelqet-Stajkë. Sipas ankuseses, në momentin e intervistës së kryer nga Komisioni i Vlerësimit, dy anëtarë të tij janë shprehur verbalisht në mënyrë të vazhdueshme, që drejtorin e ardhshëm të Shkollës 9-vjeçare “Aleksandër Paloci”, Shelqet, Vau i Dejës e dëshironin të ishte bashkëfshatar me ta, nga fshati Shelqet-Stajkë, që është edhe vendbanim i z. F.N.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”<sup>2</sup>, të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të

---

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të gjinisë, vendbanimit dhe për çdo shkak tjetër, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 7, i LMD, i ndryshuar, parashikon shprehimisht: “1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ky ligj në nenin 12, pika 1, gërmat a) dhe b) parashikon shprehimisht se: “1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve.....”.

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A. Pas analizimit të ankesës nr. 154, datë 21.12.2020, e znj. I.P., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

**B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7<sup>3</sup>, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë me shkresën nr. 1788/1, datë 24.12.2020. Kjo shkresë iu dërgua për dëgjim edhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar Tiranë dhe ankueses.

Në shkresë kërkohej informacioni vijues:

- Informacion i përgjithshëm mbi pretendimet e ankueses;
  - Kopje të akteve të praktikës mbi procedurat për konkurim për pozicionin vakant për Drejtor të Shkollës 9-vjeçare “Aleksandër Paloci”, Shelqet, Vau i Dejës, ku të përfshihen: akti i shpalljes së procedurave për konkurim, procesverbalet e mbajtura nga Komisioni i Vlerësimit për të gjithë konkurentët, kopje të dosjeve për secilin konkurent, kopje e korrespondencës me e-maile me ankuesen dhe të gjithë konkurentët e tjerë;
  - Kopje e Raportit të Vlerësimit nr. 3504/1, datë 10.12.2020, të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar dhe informacion se si është reflektuar mbi rekomandimin e këtij Raporti;
1. Në përgjigje të shkresës nr. 1788/1, datë 24.12.2020, së KMD-së, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Lezhë dërgoi shkresën nr. 2342/1, datë 06.01.2021, nëpërmjet së cilës sqaron se mbështetur në Udhëzimin e MASR nr. 2, datë 28.01.2020, “Për procedurat e emërimit pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”, Kreu 1, pika 3, DRAP Lezhë ka shpallur vende vakante për drejtues të institucioneve arsimore në juridiksion të ZVAP-ve në varësi. Me Urdhërin nr. 22, datë 03.08.2020, e DRAP Lezhë, “Për shpallje të procedurave të konkurimit” është shpallur procedura për konkurim në shkollën 9-vjeçare “Aleksandër Paloci”, Shelqet.

I.P. ka qenë kandidatë për drejtuese e kësaj shkolle. Në shkresë theksohet fakti se DRAP Lezhë ka marrë në konsideratë çdo pretendim të znj. I.P. dhe e drejta e saj për konkurim, ankimim, sikurse të gjitha të drejtat që burojnë nga legjislacioni në fuqi, janë respektuar nga ky institucion.

---

<sup>3</sup> Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, të ndryshuar, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

Lidhur me pretendimin e ankueses për diskriminim për shkak të gjinisë, DRAP Lezhë sqaron se nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Vau i Dejës aktualisht mbulon punën e 18 drejtorëve/nëndrejtorëve të institucioneve arsimore, ndër të cilët 10 janë femra. Për sa i përket pretendimit për diskriminim për shkak të vendbanimit, në shkresë vihet në dukje fakti se nga 310 drejtues dhe mësues në ZVAP Vau i Dejës, 231 të tillë vijnë nga Shkodra.

Për sa i përket procedurës së ndjekur nga DRAP Lezhë, për shpalljen e fituesit të këtij konkurimi, në shkresë theksohet fakti se janë ndjekur të gjithë hapat e parashikuar në legjislacionin respektiv.

Në datën 19.10.2020, znj. I.P. është shpallur fituese në garën e konkurimit si drejtuese në institucionin arsimor “Aleksandër Paloci” Shelqet. Mbështetur në Udhëzimin nr. 2, datë 28.01.2020, e MASR, “Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”, pika 6, shkronja d), z. F. N., kandidati tjetër për këtë pozicion pune, ka ushtruar të drejtën e ankimit pranë MASR-së.

Në zbatim të shkresës nr. 5692/1 prot., datë 28.10.2020, të Sekretarit të Përgjithshëm të MASR-së, “Për shqyrtimin e ankesës së z. Fran Ndoja”, DRAP Lezhë ka shqyrtuar ankesën në fjalë dhe në përfundim të shqyrtimit të saj ka anuluar shpalljen si fituese të znj. I.P. dhe ka emëruar definitivisht z. F. N., si drejtor në Shkollën 9-vjeçare “Aleksandër Paloci”, Shelqet. Anullimi i shpalljes ka ardhur pas një kontrolli të hollësishëm të dokumentacionit të dosjes së konkurimit së znj. I.P..

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se:

1. Znj. I.P. disponon Diplomë të Nivelit të Parë, në mësuesi për arsimin fillor, viti 2009, diplomë, e cila duhet e shoqëruar me master për të vijuar procesin e marrjes së licencës për profesionin e mësuesit.
2. Në vitin 2014, znj. I.P. ka përfunduar Master Shkencor në mësuesi për arsimin fillor (klasa 1-5).
3. Në vitin 2016, mbështetur në ligjin nr. 10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka marrë licencën për ushtrimin e profesionit të mësuesit në Arsimin Fillor.
4. Në vitin mësimor 2014-2015, ka marrë shkallën e III-të të kualifikimit. Shkalla e kualifikimit të znj. I.P. është marrë në shkelje të ligjit dhe në kundërshtim me nenin 57 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH”, i ndryshuar dhe nenit 2, pika 2, të Udhëzimit nr. 2, datë 12.02.2015, të MASR, “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit”.

Neni 57, pika 5, i Ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH”, të ndryshuar, përcakton se mësuesi i arsimit fillor, i arsimit të mesëm të ulët dhe i arsimit të mesëm të lartë,

mësuesi i shkollave të arsimit të orientuar, mësuesi i kulturës së përgjithshme në shkollat profesionale, mësuesi që punon me nxënësit me aftësi të kufizuara dhe mësuesi me diplomë të ngjashme ose të përafërt me diplomat në fushat/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar ushtron profesionin pasi:

- a) Të ketë kryer me sukses praktikën profesionale;
- b) Të ketë kaluar me sukses provimin e shtetit në fushën e formimit të tij, siç parashikohet në ligjin 10 171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Neni 2, pika 1, i Udhëzimit nr. 2, datë 12.01.2015, të MASR parashikon: “Kandidatët për kualifikim (kandidatët) janë punonjësit e institucioneve arsimore publike dhe atyre private, të cilët kanë diplomë mësuesie, sipas kriterëve të parashikuara në legjislacionin në fuqi”.

Për sa më sipër, znj. I.P. ka marrë shkallën e kualifikimit në vitin 2015, ndërkohë që Liçencën e ushtrimit të profesionit të mësuesit e ka marrë në vitin 2016. Ankuesja e ka marrë shkallën e kualifikimit në kundërshtim me kriteret për marrjen e saj, konkretisht titullin më të rëndësishëm atë të mësuesit.

Në shkresë theksohet fakti se edhe nëse ankuesja do të kishte patur diplomë të vlefshme në vitin 2015, kohë kur ka marrë shkallën e tretë të kualifikimit, përsëri do të konsiderohej e marrë në mënyrë të kundraligjshme, pasi ajo duhet të kishte 5 vjet përvojë pune, ndërkohë që realisht ajo ka vetëm 4 vjet e 3 muaj eksperience pune, në referencë të librezës së punës së dorëzuar nga ana e saj.

Në nenin 2, pika 2, e Udhëzimit nr. 2, datë 12.02.2015, parashikohet shprehimisht: “Procedurave të kualifikimit u nënshtrohen të gjithë mësuesit, të cilët deri në 31 dhjetor të viti paraardhës, plotësojnë kushtet e mëposhtëme për vjetërsinë e punës në arsim:

- a) Të paktën 5 vjet punë, për kategorinë e kualifikimit “mësues i kualifikuar”;
- b) Të paktën 10 vjet pune për kategorinë e kualifikimit “mësues specialist” dhe të paktën 5 vjet pune pas marrjes së kategorisë “mësues i kualifikuar”;
- c) Të paktën 20 vjet pune për kategorinë e kualifikimit “mësues mjeshtër” dhe të paktën 10 vjet punë pas marrjes së kategorisë “mësues specialist”;

Në shkresë theksohet fakti se këto fakte janë anashkaluar nga Komisionet e Vlerësimit të Dosjeve në shkolla dhe në këtë mënyrë dosja e ankueses është kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

ZVAP Vau i Dejës nuk e ka shqyrtuar këtë mangësi në dosjen e znj. I.P., për shkak se verifikimi është vetëm i natyrës teknike, në referim të gërmës d), të Udhëzimit nr. 2, datë 28.01.2020, të MASR.

Me konstatimin e kësaj parregullsie, DRAP Lezhë ka anuluar shpalljen e fituesit. Në vijim, DRAP Lezhë do të shqyrtojë edhe përgjegjësinë e strukturave përkatëse, që kanë lejuar kualifikimin e një dosjeje e cila nuk plotëson kriteret ligjore.

Për sa më sipër, DRAP Lezhë theksoi faktin se këto janë shkaqet e mosmiratimit të znj. I.P. si drejtuese shkollë. Ndërkohë që, ajo pritet të punësohet si mësuese , pasi është renditur e para në Shkodër në portalin “Mësues për Shqipërinë”, në profilin Cikël i Ulët.

Bashkëlidhur shkresës së DRAP Lezhë është dërguar dokumentacioni mbi procedurën e ndjekur nga ky institucion, si dhe dosjet e dy kandidatëve.

2. Në vijim të procedurave hetimore, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u realizua në datën 24.03.2021, pranë Zyrës së KMD-së.

Në seancë dëgjimore mori pjesë ankuesja dhe përfaqësuesja me autorizim e DRAP Lezhë. Znj. I.P. bëri një parashtrim të pretendimeve të saj. Ajo sqaroi se ka konkuruar për pozicionin vakant të drejtorit të shkollës 9-vjeçare “Aleksandër Paloci”, Shelqet, Vau i Dejës, ku nga 3 kandidatë konkuroes, nga të cilët 2 (dy) kanë qenë meshkuj dhe 1 (një) femër (ankuesja), ajo ka rezultuar fituese, fakt mbi të cilin, znj. I.P. është njoftuar me e-mail nga ana e DRAP Lezhë. Në vijim, ajo është njoftuar mbi anulimin e vendimit për shpallje fituese nga ana e DRAP Lezhë, fakt të cilin ankuesja e konsideron të padrejtë. Ajo thekson faktin se i ka plotësuar të gjitha kriteret për të konkuruar, në bazë të njoftimit të publikuar nga ky institucion. Pas anulimit të njoftimit të parë, DRAP Lezhë ka shpallur fitues konkurentin tjetër, z. F.N. Ankuesja sqaroi se ka bërë ankesë tek Portali i Bashkëqeverisjes. Ajo shprehet se DRAP Lezhë duhet të kishte kryer shpalljen e fituesit pas rezultatit të dalë nga shqyrtimi i ankimit të saj. E pyetur mbi faktin nëse ajo e ka bërë me dije DRAP Lezhë mbi ankimin e saj, ankuesja u shpreh se ajo nuk e ka njoftuar këtë institucion, por një gjë të tillë e ka bërë MASR. Një fakt i tillë reflektohet fare qartë edhe në Raportin e DPAP<sup>4</sup>, të datës 10.12.2020, ku citohet i gjithë procesi përkatës dhe janë evidentuar qartësisht shkeljet e DRAP Lezhë. Raporti përmbante rekomandime për DRAP Lezhë, të cilat nuk janë zbatuar.

Përfaqësuesja e DRAP Lezhë sqaroi se ky institucion shpall vendet vakante në bazë të kërkesave të institucioneve arsimore/zyrave vendore. Aktiviteti i DRAP Lezhë mbështetet në Udhëzimin nr. 2/2020 të MASR. Për efekt të situatës së krijuar prej Pandemisë Covid-19, procedurat përkatëse kanë përfunduar jashtë afatit. E pyetur për vendimin e shpalles fituese të ankueses I.P., ajo u shpreh se nuk ka një të tillë, por ekzistojnë vetëm e-maile njoftimi për shpallje fituesi, ndërkohë që i gjithë dokumentacioni mbi procedurën e ndjekur për rastin konkret është dorëzuar zyrtarisht pranë KMD-

---

<sup>4</sup> Shkurtim i Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar.

së. E pyetur se mbi cilin akt administrativ mbështetet shpallja si fituese e ankueses I.P., përfaqësuesja e DRAP Lezhë u shpreh se nuk ka një të tillë, si dhe theksoi faktin se, e tillë ka qenë procedura e konkurimit për të gjithë drejtuesit e shkollave të mbuluara nga DRAP Lezhë. Ajo sqaron se akti i fundit i procedurës përkatëse të konkurimit është urdhëri i emërimit të z. F.N. në pozicionin e drejtorit pranë kësaj shkolle. Përfaqësuesja e DRAP Lezhë sqaroi faktin se ky i fundit ka depozituar ankesë pranë MASR-së, pas shpalljes së znj. I.P., si fituese të konkurimit. Me shkresë zyrtare të MASR-së, DRAP Lezhë është njoftuar mbi ankesën e z. F.N., si dhe është udhëzuar të hetojë mbi objektin e kësaj ankese. Gjatë hetimit, DRAP Lezhë ka konstatuar se ankuesja I.P. ka marrë licencën për ushtrimin e profesionit në vitin 2016 dhe në vitin mësimor 2014-2015 ka marrë shkallën e III-të të kualifikimit. Komisioni përkatës pranë ZVAP Vau i Dejës nuk ka kryer shqyrtim të hollësishëm të dosjeve të konkurrentëve. Znj. I.P. ka marrë licencën pa patur shkallën e kualifikimit, si dhe nuk ka patur eksperiencën e duhur në punë, që është 5 vjet. DRAP Lezhë është institucioni përgjegjës për shqyrtimin e një rasti të tillë. Përfaqësuesja e DRAP Lezhë theksoi faktin se ankuesja I.P. nuk është pjesë e sistemit arsimor dhe në një konkurim, ata kandidatë që janë pjesë e sistemit arsimor kanë përparësi ndaj atyre, që nuk janë pjesë e këtij sistemi, edhe pse një gjë e tillë nuk është e parashikuar në aktet nënligjore.

Përfaqësuesit e KMD-së e pyetën përfaqësuesen e DRAP Lezhë mbi masat që ishin marrë për personat përgjegjës, në kushtet kur procedura e konkurimit ka rezultuar e paligjshme. Përfaqësuesja e DRAP Lezhë u shpreh se ndaj personave përgjegjës nuk është marrë asnjë masë. Njëkohësisht, ajo u pyet edhe mbi faktin se përse nuk ishte pritur për të përfunduar procedura ankimore e znj. I.P., e në vijim të kryhej emërimi i drejtorit të Shkollës 9-vjeçare “Aleksandër Paloci”, Vau i Dejës. Përgjigja e saj konsistoi në faktin se një gjë e tillë vendosej nga titullari i institucionit. E pyetur gjithashtu se cili ishte vlerësimi i saj mbi Raportin e DPAD, përfaqësuesja e DRAP Lezhë u përgjigj se DPAD ishte institucion epror me akt nënligjor. Drejtori i DRAP Lezhë i ka dërguar përgjigje DPAP-së se ankesa e z. F.N. është shqyrtuar dhe se është shpallur fituesi. Përfaqësuesit e KMD-së i kërkuan të depozitohej kopje e shkresës përkatëse.

Në vijim, ankuesja u shpreh se ajo ka kryer arsimin përkatës dhe kualifikimet e saj janë fituar sipas legjislacionit që ka qenë në fuqi (Udhëzimi nr. 2/2014 i MASR) dhe legjislacioni aktual nuk mund të ketë fuqi prapavepruese. Ankueses iu kërkuan ankesat e depozituara dhe përgjigjet e DRAP Lezhë.

Përfaqësuesja e DRAP Lezhë e vuri theksin edhe tek vjetërsia në punë e ankueses, e cila ishte 4 vjet e 3 muaj, ndërkohë që ajo duhet të kishte 5 vjet vjetërsi në punë, për të fituar shkallën e kualifikimit. Ajo theksoi faktin se shkalla e kualifikimit është marrë nga znj. I.P., pa patur vjetërsinë e duhur në punë. Pas kësaj, znj. I.P. pretendoi edhe për diskriminim për shkak të gjendjes arsimore, nga ana e DRAP Lezhë.



- Në vijim të seancës dëgjimore, ankuesja I.P. dërgoi e-mailin e datës 02.04.2021, nëpërmjet së cilit kërkoi kopje të dosjes së hetimit, të administruar nga Komisioneri, si dhe CD e seancës dëgjimore.
- Nëpërmjet shkresës nr.639, datë 15.04.2021, së KMD-së, ankueses iu dërguan aktet e kërkuara.
- DRAP Lezhë dërgoi pranë Komisionerit shkresën nr. 2342/2, datë 11.05.2021, nëpërmjet së cilës e informon KMD në vijim të seancës dëgjimore, lidhur me pretendimin e shtuar të znj. I.P. gjatë kësaj seance, që konsiston në diskriminim për shkak të gjendjes arsimore.

Ky pretendim i znj. I.P. u parashtrua në seancë, pasi përfaqësuesja e DRAP Lezhë vuri në dukje faktin se ankuesja ka përfutuar shkallën e kualifikimit pa përfunduar ciklin e formimit universitar sipas përcaktimeve të nenit 57, të ligjit nr. 69/2012 “Për arsimin parauniversitar në RSH”, i ndryshuar. Sipas këtij neni, mësuesi i arsimit fillor, të mesëm të ulët dhe i arsimit të mesëm të lartë, mësuesi i shkollave të arsimit të orientuar, mësuesi i kulturës së përgjithshme në shkollat profesionale, mësuesi që punon me nxënësit me aftësi të kufizuara dhe mësuesi me diplomë të ngjashme ose të përafërt me diplomat në fushat/lëndët e mësimdhënies në arsimin parauniversitar ushtron profesionin pasi: a) të ketë kryer me sukses praktikën profesionale; b) të ketë kryer me sukses provimin e shtetit, në fushën e formimit të tij, siç parashikohet në ligjin nr. 10 171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Për sa më sipër, rezulton se znj. I.P. disponon “Diplomë të Nivelit të Parë”, viti 2009, profili Mësuesi në Arsimin Fillor, Master Shkencor viti 2015, në mësuesi për klasën I-V, Licencë për ushtrimin e profesionit të mësuesit në vitin 2016. Në shkresën e DRAP Lezhë theksohet fakti se në seancë dëgjimore, ankuesja ka pohuar se me DNP të vitit 2009 ka qenë e plotësuar në nivel të formimit universitar, ndërkohë që Masteri Shkencor dhe Licenca e vitit 2016 janë kualifikime.

Në këtë kontekst, DRAP Lezhë thekson faktin se ligji bazë që rregullon të gjithë veprimtarinë e sistemit arsimor parauniversitar përcakton kritere ligjore që një shtetas në Republikën e Shqipërisë të mund të ushtrojë profesionin e mësuesit. Në nenin 5, të ligjit nr. 10 171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, janë parashikuar profesionet e rregulluara si më poshtë: “Profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë janë profesioni i: a) mjekut; b) stomatologut; c) farmacistit; ç) infermierit; d) mamisë; d) fizioterapistit; e) veterinerit; ë) arkitektit; f) inxhinierit; **g) mësuesit**;.....”.

Mbështetur në nenin 26 “Ciklet dhe titujt e studimeve universitare”, të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili ka qenë në fuqi

deri në vitin 2015, parashikohet: “1. Programet e studimeve në institucionet e arsimit të lartë organizohen në tri cikle të njëpasnjëshme: cikli i parë, cikli i dytë dhe cikli i tretë.”

Sipas këtij neni, programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuri bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme, dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh. Programet e studimeve të ciklit të parë realizohen me 180 kredite europiane (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 vite akademike. Në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë lëshohet diplomë universitare “Bachelor” në fushën e arsimimit të kryer.

Referuar dispozitës së sipërcituar, rezulton se parashikimi për Studimet e Ciklit të Dytë përfshin: Programet e studimeve “Master i shkencave” ose “Master i arteve të bukura”. Programet e studimeve të ciklit të dytë i pajisin të diplomuarit që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor në një fushë, brenda një specialiteti. Programet e studimeve të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite, ku përfshihen 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezen dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike.

DRAP Lezhë sqaron faktin se diplomat, të cilat zgjasin 3 vite akademike, janë cikël i parë studimesh, të cilësuar si “Bachelor” ose Diplomë e Nivelit të Parë, sipas përcaktimeve të Universiteteve. Në këto kushte, znj. I.P. ka plotësuar kriteret ligjore për t’u titulluar mësuese në vitin 2016, kur është licencuar në profesionin e mësuesit të arsimit fillor.

Neni 2, pika 2, i Udhëzimit nr. 2, datë 12.02.2015, të MASR, “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit” përcakton edhe një ndër kushtet kryesore, që mësuesi të kualifikohet në funksion të zhvillimit profesional. Mësuesi duhet të plotësojë kushtet e parashikuara në nenin 57 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH”, të ndryshuar, lidhur me formimin universitar.

I.P. ka marrë shkallën e kualifikimit në vitin 2016, kur nuk ka qenë licencuar. Problematika është shkelje ligjore në ish-DAR Shkodër, komisioni i së cilës, ka kaluar dosjen e kualifikimit pa përmbushur kriteret e sipërcituara.

Referuar kërkesës së KMD-së gjatë seancës dëgjimore për një kopje të aktit administrativ të shpalljes së fituesit në konkurimin e kryer për pozicionin e drejtuesit në Shkollën 9-Vjeçare “Aleksandër Paloci”, Vau i Dejës, Shkodër, DRAP Lezhë sqaron se njoftimet për fituesin janë bërë me e-mail nga adresa zyrtare e DRAP Lezhë, ndërkohë që akt administrativ ka patur vetëm pas përfundimit të ankimit dhe shpalljes së fituesit.

Lidhur me çështjen e kompetencës së organit që duhet të shqyrtonte ankimin e znj. I.P., DRAP Lezhë sqaron se në Udhëzimin nr. 2, datë 28.01.2020, të MASR, “Për procedurat e

*emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit public të arsimit parauniversitar” është përcaktuar qartë se ankimin e shqyrton drejtori i DRAP Lezhë dhe nuk citohet në asnjë rast se e shqyrton Komisioni i Shqyrtimit dhe Vlerësimit të Dokumentacionit në institucionin përkatës arsimor.*

Njëkohësisht, DRAP Lezhë e informon KMD-në se janë duke u ndjekur procedurat për emërimin definitiv të znj. I.P., si mësuese e arsimit fillor në Shkollën 9-vjeçare “Branko Kadia”, Shkodër.

- Në vijim të ndjekjes së procedurave hetimore, KMD i dërgoi ankueses elektronikisht nëpërmjet e-mailit zyrtar, shkresën nr. 2342/2, datë 11.05.2021, e DRAP Lezhë, duke i kërkuar të paraqesë prapësimet përkatëse.
- Nëpërmjet e-mailit të datës 26.05.2021, znj. I.P. u shpreh se: *“Mora dijeni për shkresën e DRAP Lezhë në lidhje me prapësimet e fundit të ankimimit tim. Do të doja t’ju kërkoja të kem më tepër kohë, deri me 15 qershor, në dispozicion në lidhje me prapësimet nga ana ime, pasi aktualisht DRAP Lezhë po ndjek një procedurë të emërimit tim definitiv në shkollën “Branko Kadia” Shkodër. Procedurë që akoma nuk është finalizuar.”*
- Në këto kushte, Komisioneri u shpreh me vendimin nr. 92, datë 28.05.2021, nëpërmjet së cilit pezulloi procedurat hetimore deri në datën 17.06.2021, si dhe kërkoi nga ankuesja që të paraqesë parashtrimet e saj brenda këtij afati.
- Në vijim, në datën 16.06.2021, ankuesja iu drejtua KMD-së me e-mail, nëpërmjet së cilit e njofton për emërimin e saj definitiv pranë Shkollës 9-Vjeçare “Branko Kadia” Shkodër, duke kërkuar njëkohësisht edhe tërheqjen e ankesës së saj ndaj DRAP Lezhë, pasi qëllimi i saj për t’u emëruar në një pozicion definitive pune, ishte arritur.

Në këto kushte, Komisioneri gjykoi se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”* (i ndryshuar), ku parashikohet: *“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”*, KMD vlerësoi se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa. Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015

*“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”<sup>5</sup>*, Komisioneri deklaroi përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 94/1, e ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 12-13 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 9-10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Përfundimin e procedurës së shqyrtimit administrativ të ankesës nr. 154, datë 21.12.2020, së znj. I.P., për shkak se ankuesja është tërhequr nga ankesa, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

Fusha – Punësim  
Shkak - gjinia, vendbanimi, gjendja arsimore & çdo shkak tjetër  
Lloji i vendimit – Arritje efektiviteti

---

<sup>5</sup> Neni 94/1, i ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* parashikon: *“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaroi përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.”*